

# STANDARDI NDËRKOMBËTAR I AUDITIMIT 800 (I RISHIKUAR)

## KONSIDERATA TË VEÇANTA—AUDITIMET E PASQYRAVE FINANCIARE TË PËRGATITURA NË PËRPTHJE ME KUADROT PËR QËLLIME TË VEÇANTA

(Ka hyrë në fuqi për auditimet e pasqyrave financiare për periudhat që kanë filluar me datën 15 Dhjetor 2016 ose pas kësaj date)

### PËRMBAJTJA

	Paragrafi (ët)
<b>Hyrje</b>	
Objekti i këtij SNA-je .....	1–3
Hyrja në Fuqi .....	4
<b>Objektivi</b> .....	<b>5</b>
<b>Përkufizimet</b> .....	<b>6–7</b>
<b>Kërkesat</b>	
Konsiderata kur Pranohet Angazhimi .....	8
Konsiderata kur Planifikohet dhe Kryhet Auditimi .....	9–10
Konsiderata në lidhje me Formimin e një Opinioni dhe Raportimin.....	11–14
<b>Zbatimi dhe Materiale të tjera Shpjeguese</b>	
Përkufizimi i Kuadrit për Qëllime të Veçanta .....	A1–A4
Konsiderata kur Pranohet Angazhimi.....	A5–A8
Konsiderata kur Planifikohet dhe Kryhet Auditimi.....	A9–A12
Konsiderata në lidhje me Formimin e një Opinioni dhe Raportimin .....	A13–A21
Shtojcë: Ilustrime të Raporteve të Audituesit të Pavarur mbi Pasqyrat Financiare për Qëllime të Veçanta	

Standardi Ndërkombëtar i Auditimit (SNA) 800 (i rishikuar), *Konsiderata të Veçanta — Auditimet e Pasqyrave Financiare të Përgatitura në Përputhje me Kuadrot për Qëllime të Veçanta*, duhet të lexohet i lidhur ngushtë me Standardin Ndërkombëtar të Auditimit (SNA) 200, *Objektivat e Përgjithshme të Audituesit të Pavarur dhe Kryerja e një Auditimi në Pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit*.

## Hyrje

### Objekti i këtij SNA-je

1. Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të) nga 100 deri në 700 zbatohen për një auditim të pasqyrave financiare. Ky SNA trajton vlerësimet e veçanta në zbatimin e atyre SNA-ve për një auditim të pasqyrave financiare të përgatitura në përputhje me një kuadër për qëllime të veçanta.
2. Ky SNA është shkruar në kontekstin e një pakete të plotë të pasqyrave financiare të përgatitura në përputhje me një kuadër për qëllime të veçanta. SNA 805 (i rishikuar)<sup>1</sup> trajton konsideratat e veçanta që lidhen me një auditim të një pasqyre financiare të vetme ose të një llogarie, elementi, apo një zëri specifik të një pasqyre financiare.
3. Ky SNA nuk tejkalon kërkesat e SNA-ve të tjera; as nuk synon të merret me të gjitha konsideratat e veçanta që mund të jenë të rëndësishme në rrethanat e angazhimit.

### Hyrja në Fuqi

4. Ky SNA hyn në fuqi për auditimet e pasqyrave financiare për periudhat që përfundojnë me datën 15 Dhjetor 2016 ose pas kësaj date.

### Objektivi

5. Objektivi i audituesit, kur ai zbaton SNA-të në një auditim të pasqyrave financiare të përgatitura në përputhje me një kuadër për qëllime të veçanta, është të adresojë në mënyrë të përshtatshme konsideratat e veçanta që kanë të bëjnë me:
  - (a) Pranimin e angazhimit;
  - (b) Planifikimin dhe kryerjen e angazhimit; dhe
  - (c) Formimin e një opinioni dhe raportimin mbi pasqyrat financiare.

### Përkufizimet

6. Për qëllimet e SNA-ve, termat në vijim kanë kuptimet e mëposhtme:
  - (a) Pasqyra financiare për qëllime të veçanta – Pasqyrat financiare të përgatitura në përputhje me një kuadër për qëllime të veçanta. (Ref: Para. A4)
  - (b) Kuadër për qëllime të veçanta – Një kuadër i raportimit financiar që synon të plotësojë nevojat për informacion financiar të përdoruesve

<sup>1</sup> SNA 805 (i rishikuar), *Konsiderata të Veçanta – Auditimet e Pasqyrave Financiare të Veçanta dhe Elementëve Specifikë, Llogarive apo Zërave të një Pasqyre Financiare.*

## KONSIDERATA TË VEÇANTA—AUDITIMET E PASQYRAVE FINANCIARE TË PËRGATTURA NË PËRPUTHJE ME KUADROT PËR QËLLIME TË VEÇANTA

specifikë. Kuadri i raportimit financiar mund të jetë një kuadër i paraqitjes së drejtë ose një kuadër i pajtueshmërisë.<sup>2</sup> (Ref: Para. A1–A4)

7. Referenca për “pasqyrat financiare” në këtë SNA, nënkupton “një paketë të plotë të pasqyrave financiare për qëllime të veçanta”. Kërkesat e kuadrit të zbatueshëm të raportimit financiar përcaktojnë formën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare si dhe atë çfarë është një paketë e plotë e pasqyrave financiare. Referenca për “pasqyrat financiare për qëllime të veçanta” përfshin shënimet shpjeguese përkatëse.

### Kërkesat

#### Konsiderata kur Pranohet Angazhimi

##### *Pranueshmëria e Kuadrit të Raportimit Financiar*

8. SNA 210 kërkon që audituesi të përcaktojë pranueshmërinë e kuadrit të raportimit financiar të zbatuar për përgatitjen e pasqyrave financiare. Në një auditim të pasqyrave financiare për qëllime të veçanta, audituesi do të sigurojë njohjen dhe kuptimin për: (Ref: Para. A5–A8)
  - (a) Qëllimin për të cilin janë përgatitur pasqyrat financiare;
  - (b) Përdoruesit e synuar; dhe
  - (c) Hapat e ndërmarrë nga drejtimi për të përcaktuar se kuadri i zbatuar i raportimit financiar është i pranueshëm për rrethanat.

#### Konsiderata kur Planifikohet dhe Kryhet Auditimi

9. SNA 200 kërkon që audituesi të veprojë në përputhje me të gjithë SNA-të që kanë të bëjnë me auditimin.<sup>3</sup> Në planifikimin dhe kryerjen e auditimit të pasqyrave financiare për qëllime të veçanta, audituesi do të përcaktojë nëse zbatimi i SNA-ve kërkon vlerësime të veçanta në rrethanat e angazhimit. (Ref: Para. A9–A12)

SNA 315 (i rishikuar) kërkon që audituesi të kuptojë mënyrën sesi entiteti zgjedh dhe zbaton politikat kontabël.<sup>4</sup> Në rastin e pasqyrave financiare të përgatitura në përputhje me parashikimet e një kontrate, audituesi do të sigurojë një kuptim në lidhje me çdo interpretim të rëndësishëm të kontratës, që ka bërë drejtimi për përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare. Një interpretim është i rëndësishëm kur adoptimi i një interpretimi tjetër të arsyeshëm, do të kishte shkaktuar një diferencë materiale në informacionin e paraqitur në pasqyrat financiare.

---

<sup>2</sup> SNA 200, *Objektivat e Përgjithshme të Audituesit të Pavarur dhe Kryerja e një Auditimi në Pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit*, paragrafi 13(a)

<sup>3</sup> SNA 200, paragrafi 18

<sup>4</sup> SNA 315 (i rishikuar), *Identifikimi dhe Vlerësimi i Rreziqeve të Anomalisë Materiale Nëpërmjet Njohjes së Entitetit dhe Mjedisit të Tij*, paragrafi 11(c)

## Konsiderata në lidhje me Formimin e një Opinioni dhe Raportimin

10. Kur formon një opinion dhe raportin mbi pasqyrat financiare për qëllime të veçanta, audituesi do të zbatojë kërkesat e SNA 700 (i rishikuar).<sup>5</sup> (Ref: Para. A13–A19)

### *Përshkrimi i Kuadrit të Zbatueshëm të Raportimit Financiar*

11. SNA 700 (i rishikuar) kërkon që audituesi të vlerësojë nëse pasqyrat financiare i referohen apo përshkruajnë si duhet kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar.<sup>6</sup> Në rastin e pasqyrave financiare të përgatitura në përputhje me parashikimet e një kontrate, audituesi do të sigurojë nëse pasqyrat financiare përshkruajnë siç duhet çdo interpretim të rëndësishëm të kontratës mbi të cilën bazohen pasqyrat financiare.
12. SNA 700 (i rishikuar) trajton formën dhe përmbajtjen e raportit të audituesit, përfshirë renditjen specifike për elementë të caktuar. Në rastin e raportit të një audituesi për pasqyrat financiare për qëllime të veçanta:
  - (a) Raporti i audituesit do të përshkruajë gjithashtu qëllimin për të cilin janë përgatitur pasqyrat financiare dhe, nëse është e nevojshme, përdoruesit e synuar, ose referimi i një shënimi në pasqyrat financiare për qëllime të veçanta që përmban atë informacion; dhe
  - (b) Nëse drejtimi ka një mundësi zgjedhje të kuadrove të raportimit financiar në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare, shpjegimi i përgjegjësishë së drejtimit për pasqyrat financiare gjithashtu do t'i referohet përgjegjësishë së tij për përcaktimin se kuadri i zbatueshëm i raportimit financiar është i pranueshëm për rrethanat.

### *Paralajmërimi i Lexuesve se Pasqyrat Financiare janë Përgatitur në Përputhje me një Kuadër për Qëllime të Veçanta*

13. Raporti i audituesit për pasqyrat financiare për qëllime të veçanta do të përfshijë një paragraf që thekson Çështjen duke paralajmëruar përdoruesit e raportit të audituesit, se pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me një kuadër për qëllime të veçanta dhe si rezultat i këtij fakti, pasqyrat financiare mund të mos jenë të përshtatshme për një qëllim tjetër. (Ref: Para. A20–A21)

\*\*\*

## Zbatimi dhe Materiale të Tjera Shpjeguese

### Përkufizimi i Kuadrit për Qëllime të Veçanta (Ref: Para. 6)

<sup>5</sup> SNA 700 (i rishikuar), *Formimi i një Opinioni dhe Raportimi mbi Pasqyrat Financiare*

<sup>6</sup> SNA 700 (i rishikuar), paragrafi 15

**KONSIDERATA TË VEÇANTA—AUDITIMET E PASQYRAVE FINANCIARE TË PËRGATITURA NË PËRPUTHJE ME KUADROT PËR QËLLIME TË VEÇANTA**

A1. Shembuj të kuadrove për qëllime të veçanta janë:

- Një bazë tatimore kontabël për një paketë të pasqyrave financiare që shoqëron deklaratën tatimore të një entiteti;
- Baza kontabël e arkëtimeve dhe disbursimeve të parave për informacionin e flukseve të parasë që një entiteti mund t'i kërkojë të përgatisë për kreditorët;
- Dispozitat e raportimit financiar të vendosura nga një rregullator për të përmbushur kërkesat e këtij rregullatori; ose
- Dispozitat e raportimit financiar të një kontrate, të tilla si një kontratë bonosh, një marrëveshje kredie, ose një grant projekti.

A2. Mund të ketë rrethana kur një kuadër për qëllime të veçanta bazohet në një kuadër të raportimit financiar të vendosur nga një organizatë e autorizuar ose e njohur për hartimin e standardeve apo nga ligji ose rregullat, por që nuk është në pajtim me të gjitha kërkesat e këtij kuadri. Një shembull është një kontratë që kërkon që pasqyrat financiare të përgatiten në përputhje me shumicën, por jo të gjitha, të Standardeve të Raportimit Financiar të Juridiksionit X. Kur kjo është e pranueshme në rrethanat e angazhimit, do të ishte e papërshtatshme që përshkrimi i kuadrit të zbatueshëm të raportimit financiar në pasqyrat financiare për qëllime të veçanta të shprehej për pajtueshmëri të plotë me kuadrin e raportimit financiar të vendosur nga organizata e autorizuar ose e njohur për hartimin e standardeve ose nga ligji apo nga rregullat. Në shembullin e mësipërm të kontratës, përshkrimi i kuadrit të zbatueshëm për raportimin financiar mund t'i referohet dispozitave të raportimit financiar të kontratës, në vend që të bëjë ndonjë referencë në Standardet e Raportimit Financiar të Juridiksionit X.

A3. Në rrethanat e përshkruara në paragrafin A2, kuadri për qëllime të veçanta mund të mos jetë një kuadër i paraqitjes së drejtë edhe nëse kuadri i raportimit financiar në të cilin ai është bazuar është një kuadër i paraqitjes së drejtë. Kjo për shkak se kuadri për qëllime të veçanta mund të mos përputhet me të gjitha kërkesat e kuadrit të raportimit financiar të vendosura nga një organizatë e autorizuar ose e njohur për hartimin e standardeve, ose nga ligji apo nga rregullat që janë të nevojshme për të arritur paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare.

A4. Pasqyrat financiare të përgatitura në përputhje me një kuadër për qëllime të veçanta mund të jenë pasqyra e vetme financiare që përgatit entiteti. Në rrethana të tilla, këto pasqyra financiare mund të përdoren nga përdorues të ndryshëm nga ata për të cilët është hartuar kuadri i raportimit financiar. Pavarësisht nga shpërndarja e gjerë e pasqyrave financiare në këto rrethana, ato ende konsiderohen si pasqyra financiare për qëllime të veçanta për qëllimet e SNA-ve. Kërkesat në paragrafët 13-14, synojnë të shmangin keqkuptimet në lidhje me qëllimin për të cilin përgatiten pasqyrat financiare.

## KONSIDERATA TË VEÇANTA—AUDITIMET E PASQYRAVE FINANCIARE TË PËRGATITURA NË PËRPUTHJE ME KUADROT PËR QËLLIME TË VEÇANTA

Shënimet shpjeguese, përmbajnë informacione shpjeguese ose përshkruese, të përcaktuara siç kërkohet, shprehimisht të lejuara ose përndryshe të lejuara nga kuadri i raportimit financiar, në trupin e pasqyrave financiare, ose në shënimet shpjeguese, ose të përfshira përmes një reference të kryqëzuar.<sup>7</sup>

### Konsiderata kur Pranohet Angazhimi

*Pranueshmëria e Kuadrit të Raportimit Financiar (Ref: Para. 8)*

- A5. Në rastin e pasqyrave financiare për qëllime të veçanta, nevojat për informacion financiar të përdoruesve të synuar janë një faktor kryesor në përcaktimin e pranueshmërisë së kuadrit të raportimit financiar që zbatohet për përgatitjen e pasqyrave financiare.
- A6. Kuadri i zbatueshëm i raportimit financiar mund të përfshijë standarde të raportimit financiar të vendosura nga një organizatë e autorizuar ose e njohur për të publikuar standardet për pasqyrat financiare për qëllime të veçanta. Në këtë rast, këto standarde do të supozohen të pranueshme për këtë qëllim nëse organizata ndjek një proces të paracaktuar dhe transparent që përfshin diskutimin dhe marrjen në konsideratë të pikëpamjeve të palëve të interesuara përkatëse. Në disa juridiksione, ligji ose rregullat mund të përcaktojnë kuadrin e raportimit financiar që do të përdoret nga drejtimi për përgatitjen e pasqyrave financiare për qëllime të veçanta për një lloj të caktuar të entiteteve. Për shembull, një rregullator mund të vendosë dispozita të raportimit financiar për të përmbushur kërkesat e këtij rregullatori. Në mungesë të treguesve për të kundërtën, një kuadër i tillë i raportimit financiar supozohet se është i pranueshëm për pasqyra financiare për qëllime të veçanta të përgatitura nga një entitet i tillë.
- A7. Kur standardet e raportimit financiar të referuara në paragrafin A6 plotësohen me kërkesa legjislative ose rregullatore, SNA 210 kërkon që audituesi të përcaktojë nëse ka konflikte midis standardeve të raportimit financiar dhe kërkesave shtesë, dhe përshkruan veprimet që duhet të ndërmerren nga audituesi nëse këto konflikte ekzistojnë.<sup>8</sup>
- A8. Kuadri i zbatueshëm i raportimit financiar mund të përmbledhë dispozitat e raportimit financiar të një kontrate, ose burime të ndryshme nga ato të përshkruara në paragrafët A6 dhe A7. Në këtë rast, pranueshmëria e kuadrit të raportimit financiar në rrethanat e një angazhimi përcaktohet duke vlerësuar nëse kuadri përmban atributet e shfaqura normalisht nga kuadri i zbatueshëm i raportimit financiar siç përshkruhet në Shtojcën 2 të SNA 210. Në rastin e kuadrit për qëllime të veçanta, rëndësia relative për një angazhim të veçantë të secilit prej attributeve të shfaqura nga kuadri i zbatueshëm i raportimit financiar është një çështje e gjykimit profesional.

<sup>7</sup> SNA 200, paragrafi 13(f)

<sup>8</sup> SNA 210, paragrafi 18

**KONSIDERATA TË VEÇANTA—AUDITIMET E PASQYRAVE FINANCIARE TË PËRGATITURA NË PËRPUTHJE ME KUADROT PËR QËLLIME TË VEÇANTA**

Për shembull, për qëllime të përcaktimit të vlerës së aktiveve neto të një entiteti në datën e shitjes së tyre, shitësi dhe blerësi mund të kenë rënë dakort që çmuarjet shumë të kujdesshme të zbritjeve të llogarive të arkëtueshme të pambledhshme, janë të përshatshme për nevojat e tyre, edhe pse ky informacion financiar nuk është neutral kur krahasohet me informacionin financiar të përgatitur në përputhje me një kuadër për qëllime të përgjithshme.

**Konsiderata kur Planifikohet dhe Kryhet Auditimi (Ref: Para. 9)**

- A9. SNA 200 kërkon që audituesi të jetë në pajtim me (a) kërkesat etike përkatëse, përfshirë ato që i përkasin pavarësisë, në lidhje me angazhimet e auditimit të pasqyrave financiare, dhe (b) me të gjitha SNA-të që lidhen me auditimin. Ai kërkon gjithashtu, që audituesi të përmbushë çdo kërkesë të një SNA-je, përveç nëse, në rrethanat e auditimit, i gjithë SNA nuk është i rëndësishëm ose kërkesa nuk është e rëndësishme sepse është e kushtëzuar dhe kushti nuk ekziston. Në rrethana përjashtimore, audituesi mund të gjykojë të nevojshme të devijojë nga një kërkesë përkatëse në një SNA duke kryer procedura alternative të auditimit për të arritur qëllimin e kësaj kërkesë.<sup>9</sup>
- A10. Zbatimi i disa nga kërkesat e SNA-ve në një auditim të pasqyrave financiare për qëllime të veçanta mund të kërkojë vlerësime të veçanta nga audituesi. Për shembull, në SNA 320, gjykimet rreth çështjeve që janë materiale për përdoruesit e pasqyrave financiare janë të bazuara në një vlerësim të nevojave të zakonshme për informacione financiare të përdoruesve si një grup.<sup>10</sup> Sidoqoftë, në rastin e një auditimi të pasqyrave financiare për qëllime të veçanta, këto gjykime janë bazuar në një vlerësim të nevojave për informacione financiare, përdoruesve të synuar.
- A11. Në rastin e pasqyrave financiare për qëllime të veçanta, të tilla si ato të përgatitura në përputhje me kërkesat e një kontrate, drejtimi mund të bierë dakort me përdoruesit e synuar për një kufi nën të cilin anomalitë e identifikuar gjatë auditimit nuk do të korrigjohen ose përndryshe të rregullohen. Ekzistenca e një kufiri të tillë nuk e çliron audituesin nga kërkesa për të përcaktuar materialitetin në përputhje me SNA 320 për qëllime të planifikimit dhe kryerjes së auditimit për pasqyrat financiare për qëllime të veçanta.
- A12. SNA 260 (i rishikuar) kërkon që audituesi të përcaktojë personin (personat) e duhur brenda strukturës qeverisëse të entitetit më të cilin ai do komunikojë.<sup>11</sup> SNA 260 (i rishikuar) vëren se, në disa raste, të gjithë

---

<sup>9</sup> SNA 200, paragrafët 14, 18 dhe 22–23

<sup>10</sup> SNA 320, *Materialiteti në Planifikimin dhe Kryerjen e një Auditimi*, paragrafi 2

<sup>11</sup> SNA 260 (i rishikuar), *Komunikimi me Personat e Ngarkuar me Qeverisjen*

## KONSIDERATA TË VEÇANTA—AUDITIMET E PASQYRAVE FINANCIARE TË PËRGATITURA NË PËRPUTHJE ME KUADROT PËR QËLLIME TË VEÇANTA

personat e ngarkuar me qeverisjen janë të përfshirë në drejtimin e entitetit, dhe zbatimi i kërkesave të komunikimit modifikohet për të njohur këtë pozicion.<sup>12</sup> Kur një paketë e plotë e pasqyrave financiare për qëllime të përgjithshme është përgatitur gjithashtu nga entiteti, ai (ata) persona (at) përgjegjës për mbikëqyrjen e përgatitjes së pasqyrave financiare për qëllime të veçanta nuk mund të jenë të njejtët me ata të ngarkuar me qeverisjen përgjegjës për mbikëqyrjen e përgatitjes së pasqyrave financiare për qëllime të përgjithshme.

### **Konsiderata në lidhje me Formimin e një Opinioni dhe Raportimi (Ref: Para.11)**

A13. Shtojca e këtij SNA-je përmban ilustrime për raportin e audituesit të pavarur për pasqyrat financiare për qëllime të veçanta. Ilustrime të tjera të raporteve të audituesit mund të jenë të rëndësishme për raportimin e pasqyrave financiare për qëllime të veçanta (shih për shembull, Shtojcat në SNA 700 (i rishikuar), SNA 705 (i rishikuar),<sup>13</sup> SNA 570 (i rishikuar)<sup>14</sup>, SNA 720 (i rishikuar)<sup>15</sup> dhe SNA 706 (i rishikuar)).<sup>16</sup>

### *Zbatimi i SNA 700 (i rishikuar) kur Raportohet për Pasqyrat Financiare për Qëllime të Veçanta*

A14. Paragrafi 11 i këtij SNA-je shpjegon se audituesi është i detyruar të zbatojë SNA 700 (i rishikuar) kur formon një opinion dhe raportin për pasqyrat financiare për qëllime të veçanta. Duke vepruar kështu, audituesi është i detyruar të zbatojë kërkesat për raportim në SNA-të e tjera dhe gjithashtu ai mund t'i gjejë të dobishme konsideratat e veçanta të trajtuara në paragrafët A15-A19 më poshtë.

### **Vijueshmëria**

A15. Pasqyrat financiare për qëllime të veçanta mundet ose nuk mundet të përgatiten në përputhje me një kuadër të raportimit financiar për të cilin zbatohet baza e kontabilitetit për vijueshmërinë (p.sh, baza e kontabilitetit për vijueshmërinë nuk është e përshtatshme për disa pasqyra financiare të përgatitura mbi bazën tatimore në juridiksione të veçanta).<sup>17</sup> Në varësi të kuadrit të zbatueshëm të raportimit financiar të përdorur në përgatitjen e pasqyrave financiare për qëllime të veçanta, përshkrimi në raportin e audituesit të përgjegjësive të drejtimit<sup>18</sup> lidhur me vijueshmërinë do të

<sup>12</sup> SNA 260 (i rishikuar), paragrafi A8

<sup>13</sup> SNA 705 (i rishikuar), *Modifikimet e Opinioni në Raportin e Audituesit të Pavarur*

<sup>14</sup> SNA 570 (i rishikuar), *Vijueshmëria*

<sup>15</sup> SNA 720 (i rishikuar), *Përgjegjësitë e Audituesit në Lidhje me Informacionet e Tjera*

<sup>16</sup> SNA 706 (i rishikuar), *Paragrafët që Theksojnë Çështjen dhe Paragrafët për Çështje të Tjera*

<sup>17</sup> SNA 570 (i rishikuar), paragrafi 2

<sup>18</sup> Shih SNA 700 (i rishikuar), paragrafët 34(b) dhe A48.



## KONSIDERATA TË VEÇANTA—AUDITIMET E PASQYRAVE FINANCIARE TË PËRGATITURA NË PËRPUTHJE ME KUADROT PËR QËLLIME TË VEÇANTA

duhet të përshtatet sipas nevojës. Përshkrimi në raportin e audituesit të përgjegjësive të audituesit<sup>19</sup> gjithashtu mund të ketë nevojë të përshtatet sipas rastit në varësi të mënyrës sesi SNA 570 (i rishikuar) zbatohet në rethanat e angazhimit.

### Çështjet Kryesore të Auditimit

A16. SNA 700 (i rishikuar) kërkon që audituesi të komunikojë çështjet kryesore të auditimit në përputhje me SNA 701<sup>20</sup> për auditimet e paketave të plota të pasqyrave financiare për qëllime të përgjithshme të entiteteve të listuara. Për auditimet e pasqyrave financiare për qëllime të veçanta, SNA 701 zbatohet vetëm nëse komunikimi i çështjeve të rëndësishme të auditimit në raportin e audituesit për pasqyrat financiare për qëllime të veçanta kërkohej nga ligji apo rregullat ose përndryshe audituesi vendos për të komunikuar çështjet e rëndësishme të auditimit. Kur çështjet e rëndësishme të auditimit janë komunikuar në raportin e audituesit për pasqyrat financiare për qëllime të veçanta, SNA 701 zbatohet në tërësinë e tij.<sup>21</sup>

### Informacione të Tjera

A17. SNA 720 (i rishikuar) trajton përgjegjësitë e audituesit në lidhje me informacionet e tjera. Në kontekstin e këtij SNA-je, raportet që përmbajnë ose shoqërojnë pasqyrat financiare për qëllime të veçanta – qëllimi i të cilave është t'ju sigurojë pronarëve (ose palëve të interesuara të ngjashme) informacione mbi çështjet e paraqitura në pasqyrat financiare për qëllime të veçanta – konsiderohen se janë raporte vjetore për qëllime të SNA 720 (i rishikuar). Në rastin e pasqyrave financiare të përgatitura duke përdorur një kuadër për qëllime të veçanta, termi “palë të interesuara të ngjashme” përfshin përdoruesit specifike, nevojat për informacione financiare të të cilëve plotësohen nga hartimi i kuadrit për qëllime të veçanta, i përdorur për të përgatitur pasqyra financiare për qëllime të veçanta. Kur audituesi përcakton se entiteti planifikon të lëshojë një raport të tillë, për një auditim të pasqyrave financiare për qëllime të veçanta zbatohen kërkesat e SNA 720 (i rishikuar).

### Emri i Ortakut të Angazhimit

A18. Kërkesat e SNA 700 (i rishikuar) që audituesi të përfshijë emrin e ortakut të angazhimit në raportin e audituesit zbatohen gjithashtu në auditimin e pasqyrave financiare për qëllime të veçanta të entiteteve të listuara.<sup>22</sup> Audituesit mund t'i kërkohej me ligj apo me rregullore të përfshijë emrin e

<sup>19</sup> Shih SNA 700 (i rishikuar), paragrafi 39(b)(iv).

<sup>20</sup> SNA 701, *Komunikimi i Çështjeve Kryesore të Auditimit në Raportin e Audituesit të Pavarur*

<sup>21</sup> SNA 700 (i rishikuar), paragrafi 31

<sup>22</sup> Shih SNA 700 (i rishikuar), paragrafët 45 dhe A56–A58

## KONSIDERATA TË VEÇANTA—AUDITIMET E PASQYRAVE FINANCIARE TË PËRGATITURA NË PËRPUTHJE ME KUADROT PËR QËLLIME TË VEÇANTA

ortakut të angazhimit në raportin e audituesit ose përndryshe, mund të vendosë ta bëjë këtë gjë kur raportin për pasqyrat financiare për qëllime të veçanta të entiteteve të ndryshme nga ato të listuara.

### *Përfshirja e një Reference në Raportin e Audituesit për Paketën e Plotë të Pasqyrave Financiare për Qëllime të Përgjithshme*

A19. Audituesi mund ta gjykojë të përshtatshme të referojë, në një paragraf për Çështje të Tjera në raportin e audituesit për pasqyrat financiare për qëllime të veçanta, në raportin e audituesit për paketën e plotë të pasqyrave financiare për qëllime të përgjithshme ose në çështjen (çështjet) e raportuara në të (shih SNA 706 (i rishikuar)).<sup>23</sup> Për shembull, audituesi mund të konsiderojë të përshtatshme të referojë në raportin e audituesit mbi pasqyrat financiare për qëllime të veçanta në një seksion të Pasigurisë Materiale të Lidhur me Vijueshmërinë të përfshirë në raportin e audituesit për paketën e plotë të pasqyrave financiare për qëllime të përgjithshme.

### *Paralajmërimi i Lexuesve se Pasqyrat Financiare Janë Përgatitur në Pajtim me një Kuadër të Qëllimeve të Veçanta (Ref: Para. 14)*

A20. Pasqyrat financiare për qëllime të veçanta mund të përdoren për qëllime të ndryshme nga ato për të cilat ishin menduar. Për shembull, një rregullator mund të kërkojë që disa entitete të bëjnë publike pasqyrat financiare për qëllime të veçanta. Për të shmangur keqkuptimet, audituesi paralajmëron përdoruesit e raportit të audituesit duke përfshirë një paragraf që Thekson një Çështje duke sqaruar se pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me një kuadër për qëllime të veçanta dhe, për këtë arsye, mund të mos jenë të përshtatshme për ndonjë qëllim tjetër. SNA 706 (i rishikuar) kërkon që ky paragraf të përfshihet në një seksion të veçantë të raportit të audituesit me një titull të përshtatshëm që përfshin termin “Theksim i një Çështje”.<sup>24</sup>

### *Kufizimi i Shpërndarjes ose Përdorimit (Ref: Para. 14)*

A21. Përveç paralajmërimit të kërkuar nga paragrafi 14, audituesi mund të konsiderojë të përshtatshme të tregojë se raporti i audituesit është parashikuar vetëm për përdorues specifikë. Në varësi të ligjit ose rregullave të një juridiksioni të veçantë, kjo mund të arrihet duke kufizuar shpërndarjen ose përdorimin e raportit të audituesit. Në rrethana të tilla, paragrafi i referuar në paragrafin 14 mund të zgjerohet për të përfshirë këto çështje, dhe titulli modifikohet në përputhje me rrethanat (shih ilustrimet në Shtojcën e këtij SNA-je).

<sup>23</sup> Shih SNA 706 (i rishikuar), paragrafët 10–11.

<sup>24</sup> Shih paragrafin 9(a) të SNA 706 (i rishikuar)



**Ilustrime të Raporteve të Audituesit të Pavarur mbi Pasqyrat Financiare për Qëllime të Veçanta**

- Ilustrimi 1: Një raport i audituesit për një paketë të plotë të pasqyrave financiare të një entiteti jo të listuar, të përgatitur në përputhje me dispozitat e raportimit financiar të një kontrate (për qëllime të këtij ilustrimi, një kuadër i pajtueshmërisë).
- Ilustrimi 2: Një raport i audituesit për një paketë të plotë të pasqyrave financiare të një entiteti jo të listuar, të përgatitur në përputhje me bazën kontabël tatimore në Juridiksionin X (për qëllime të këtij ilustrimi, një kuadër i pajtueshmërisë).
- Ilustrimi 3: Një raport i audituesit për një paketë të plotë të pasqyrave financiare të një entiteti jo të listuar, të përgatitur në përputhje me dispozitat e raportimit financiar të vendosura nga një rregullator (për qëllime të këtij ilustrimi, një kuadër të paraqitjes së drejtë).

**Ilustrimi 1: Një raport i audituesit për një paketë të plotë të pasqyrave financiare të një entiteti jo të listuar, të përgatitur në përputhje me dispozitat e raportimit financiar të një kontrate (për qëllime të këtij ilustrimi, një kuadër i pajtueshmërisë).**

Për qëllime të këtij raporti ilustrues të audituesit, supozohen rrethanat e mëposhtme:

- Pasqyrat financiare janë përgatitur nga drejtimi i entitetit në përputhje me dispozitat e raportimit financiar të një kontrate (që është, një kuadër për qëllime të veçanta). Drejtimi nuk ka një zgjedhje të kuadrove të raportimit financiar.
- Kuadri i zbatueshëm i raportimit financiar është një kuadër i pajtueshmërisë.
- Një raport i audituesit për një paketë të plotë të pasqyrave financiare për qëllime të përgjithshme nuk është publikuar.
- Kushtet e angazhimit të auditimit reflektojnë përshkrimin e përgjegjësisë së drejtimit për pasqyrat financiare, sipas SNA 210.
- Bazuar në evidencën e auditimit të siguar, audituesi ka arritur në përfundimin se duhet të jepet një opinion i pamodifikuar (d.m.th. “i pastër”).
- Kërkesat përkatëse etike që zbatohen për auditimin janë ato të juridiksionit.
- Bazuar në evidencën e auditimit të siguar, audituesi ka arritur në përfundimin se nuk ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e entitetit për të vijuar veprimarinë sipas SNA 570 (i rishikuar).
- Shpërndarja dhe përdorimi i raportit të audituesit janë të kufizuara.
- Audituesit nuk i kërkohet, dhe përndryshe ai nuk ka vendosur të komunikojë çështjet kryesore të auditimit në pajtim me SNA 701.
- Audituesi ka përcaktuar se nuk ka asnjë informacion tjetër (p.sh., kërkesat e SNA 720 (i rishikuar) nuk zbatohen).
- Ata që janë përgjegjës për mbikëqyrjen e pasqyrave financiare ndryshojnë nga ata që janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare.
- Audituesi nuk ka përgjegjësi të tjera për të raportuar, të cilat të kërkohen nga ligji dhe rregullat lokale.

**KONSIDERATA TË VEÇANTA—AUDITIMET E PASQYRAVE FINANCIARE TË  
PËRGATITURA NË PËRPUTHJE ME KUADROT PËR QËLLIME TË VEÇANTA**

**RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR**

[Adresa e duhur]

**Opinion**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë tregtare ABC (shoqëria), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 20X1, dhe pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur të Shoqërisë për vitin që mbyllet në datën 31 Dhjetor 20X1, janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me dispozitat e raportimit financiar të seksionit Z të kontratës datë 1 Janar 20X1 midis Shoqërisë dhe Shoqërisë DEF (“kontrata”).

**Baza për Opinionin**

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në [juridiksionin], dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

**Theksim i Çështjes – Baza Kontabël dhe Kufizimet në Shpërndarje dhe Përdorim**

Ne tërheqim vëmendjen tek Shënimi X në pasqyrat financiare, i cili përshkruan bazën kontabël. Pasqyrat financiare janë përgatitur për të ndihmuar Shoqërinë në pajtueshmërinë me dispozitat e raportimit financiar të kontratës së përmenduar më lartë. Si rezultat, pasqyrat financiare mund të mos jenë të përshtatshme për një qëllim tjetër. Raporti ynë ka për qëllim vetëm Shoqërinë dhe Shoqërinë DEF dhe nuk duhet të shpërndahet apo të përdoret nga palët përveç Shoqërisë ose Shoqërisë DEF. Opinionin ynë nuk është i modifikuar lidhur me këtë çështje.

**Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare<sup>25</sup>**

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me dispozitat e raportimit financiar të Seksionit Z të kontratës dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacione, kur kjo është e

---

<sup>25</sup> Gjatë gjithë këtyre raporteve ilustruese të audituesit, termat drejtimi dhe personat e ngarkuar me qeverisjen mund të jetë e nevojshme të zëvendësohen nga terma të tjerë që janë të përshtatshëm në kontekstin e kuadrit ligjor në juridiksionin e caktuar.

KONSIDERATA TË VEÇANTA—AUDITIMET E PASQYRAVE FINANCIARE TË  
PËRGATITURA NË PËRPUTHJE ME KUADROT PËR QËLLIME TË VEÇANTA

zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç nëse drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveçse të veprojë në këtë mënyrë.

Personat që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

### **Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare**

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Paragrafi 41(b) i SNA 700 (i rishikuar) shpjegon se materiali i hijëzuar më poshtë mund të vendoset në një Shtojcë të raportit të audituesit. Paragrafi 41(c) shpjegon se referenca mund të bëhet tek faqja e internetit e autoritetit të përshtatshëm, që përmban përgjegjësitë e audituesit, kur ligji, rregullat ose standardet kombëtare të auditimit e lejojnë shprehimisht, në vend që ta përfshijmë këtë material në raportin e audituesit, duke u siguruar që përsëkrimi në faqen e internetit trajton, dhe nuk është në kundërshtim me, përsëkrimin e përgjegjësive të audituesit më poshtë.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale në pasqyrat financiare, goftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, ose anashkalime të kontrolleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.<sup>26</sup>
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.

<sup>26</sup> Kjo fjali do të modifikohet, sipas rastit, në rrethanat kur audituesi së bashku me auditimin e pasqyrave financiare ka përgjegjësi edhe për të lëshuar një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm.

**KONSIDERATA TË VEÇANTA—AUDITIMET E PASQYRAVE FINANCIARE TË  
PËRGATITURA NË PËRPUTHJE ME KUADROT PËR QËLLIME TË VEÇANTA**

- Nxjerrim konkluzion mbi përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

*[Nënshkrimi në emër të firmës së auditimit, emrin personal të audituesit ose të dyja bashkë, cilado është e përshtatshme në juridiksionin e caktuar]*

*[Adresa e Audituesit] [Vendoset data dhe adresa]*

*[Data]*



**Ilustrimi 2: Një raport i audituesit për një paketë të plotë të pasqyrave financiare të një entiteti jo të listuar të përgatitur në përputhje me bazën kontabël tatimore në Juridiksionin X (për qëllime të këtij ilustrimi, një kuadër të pajtueshmërisë).**

Për qëllime të këtij raporti ilustrues të audituesit, supozohen se ekzistojnë rrethanat e mëposhtme:

- Pasqyrat financiare janë përgatitur nga drejtimi i një partneriteti, në përputhje me bazën kontabël tatimore në Juridiksionin X (që është një kuadër për qëllime të veçanta), për të ndihmuar partnerët në përgatitjen e deklaratave tatimore individuale. Drejtimi nuk ka një zgjedhje të kuadrove të raportimit financiar.
- Kuadri i zbatueshëm i raportimit financiar është një kuadër i pajtueshmërisë.
- Kushtet e angazhimit të auditimit reflektojnë përshkrimin e përgjegjësisë së drejtimit për pasqyrat financiare, sipas SNA 210.
- Bazuar në evidencën e auditimit të siguar, audituesi ka arritur në përfundimin se duhet të jepet një opinion i pamodifikuar (d.m.th. “i pastër”).
- Kërkesat përkatëse etike që zbatohen për auditimin janë ato të juridiksionit.
- Bazuar në evidencën e auditimit të siguar, audituesi ka arritur në përfundimin se nuk ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e entitetit për të vijuar veprimarinë sipas SNA 570 (i rishikuar).
- Shpërndarja e raportit të audituesit është e kufizuar.
- Audituesit nuk i kërkohet, dhe ai përndryshe nuk ka vendosur, të komunikojë çështjet kryesore të auditimit në pajtim me SNA 701.
- Audituesi ka përcaktuar se nuk ka asnjë informacion tjetër (dmth, nuk zbatohen kërkesat e SNA 720 (i rishikuar)).
- Personat që janë përgjegjës për mbikëqyrjen e pasqyrave financiare ndryshojnë nga ata që janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare.
- Audituesi nuk ka përgjegjësi të tjera për të raportuar, të cilat të kërkohen nga ligji dhe rregullat lokale.

**KONSIDERATA TË VEÇANTA—AUDITIMET E PASQYRAVE FINANCIARE TË  
PËRGATITURA NË PËRPUTHJE ME KUADROT PËR QËLLIME TË VEÇANTA**

**RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR**

[Adresa e duhur]

**Opinion**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Partneritetit ABC (partneriteti), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 20X1, dhe pasqyrën e të ardhurave për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur të partneritetit për vitin që mbyllet në datën 31 Dhjetor 20X1 janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me [përshkruaj ligjin e zbatueshëm për të ardhurat] të juridiksionit X.

**Baza për Opinionin**

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Partneriteti në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në [juridiksionin], dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

**Theksimi i Çështjes – Baza Kontabël dhe Kufizimet në Shpërndarje dhe Përdorim**

Ne tërheqim vëmendjen tek Shënimi X në pasqyrat financiare, i cili përshkruan bazën kontabël. Pasqyrat financiare janë përgatitur për të ndihmuar partnerët në përgatitjen e deklaratave të tyre tatimore individuale. Si rezultat, pasqyrat financiare mund të mos jenë të përshtatshme për një qëllim tjetër. Raporti ynë është parashikuar vetëm për Partneritetin dhe partnerët e tij dhe nuk duhet të shpërndahet tek paët e tjera përveç Partneritetit ose partnerëve të tij. Opinionin ynë nuk është i modifikuar lidhur me këtë çështje.

**Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare<sup>27</sup>**

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me bazën kontabël tatimore në Juridiksionin X dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, sipas rastit, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç rastit kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveçse të veprojë në këtë mënyrë.

Personat që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Partneritetit.

---

<sup>27</sup> Ose terma të tjerë që janë të përshtatshëm në kontekstin e kuadrit ligjor në juridiksionin e caktuar.

## **Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare**

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është garanci që një auditim i kryer sipas Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-ve) do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Paragrafi 41(b) i SNA 700 (i rishikuar) shpjegon se materiali i hijëzuar më poshtë mund të vendoset në një Shtojcë të raportit të audituesit. Paragrafi 41(c) shpjegon se referenca mund të bëhet tek faqja e internetit e autoritetit të përshtatshëm e cila përmban përgjegjësitë e audituesit, kur ligji, rregullat ose standardet kombëtare të auditimit e lejojnë shprehimisht, në vend që ky material të përfshihet në raportin e audituesit, duke siguruar që përshkrimi në faqen e internetit trajton, dhe nuk është në kundërshtim me, përshkrimin e përgjegjësive të audituesit më poshtë.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajme skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale në pasqyrat financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Partneritetit.<sup>28</sup>
- Nxjerrim konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijmësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, që mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë të auditimit.

<sup>28</sup> Kjo fjali duhet të modifikohet, sipas rastit, në rrethanat kur audituesi së bashku me auditimin e pasqyrave financiare ka gjithashtu përgjegjësinë për të lëshuar një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm.

**KONSIDERATA TË VEÇANTA—AUDITIMET E PASQYRAVE FINANCIARE TË  
PËRGATITURA NË PËRPUTHJE ME KUADROT PËR QËLLIME TË VEÇANTA**

Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.

- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

*[Nënshkrimi në emër të firmës së auditimit, emrin personal të audituesit ose të dyja bashkë, cilado është e përshtatshme në juridiksionin e caktuar]*

*[Adresa e Audituesit] [Vendoset data dhe adresa]*

*[Data]*

**Ilustrimi 3: Një raport i audituesit për një paketë të plotë të pasqyrave financiare të një entiteti jo të listuar të përgatitur në përputhje me dispozitat e raportimit financiar të një rregullatori (për qëllime të këtij ilustrimi, një kuadër i paraqitjes së drejtë).**

Për qëllime të këtij raporti ilustrues të audituesit, supozohet se ekzistojnë rrethanat e mëposhtme:

- Auditimi i një pakete të plotë të pasqyrave financiare të një entiteti jo të listuar, të cilat janë përgatitur nga drejtimi i entitetit në përputhje me dispozitat e raportimit financiar të një rregullatori (që është, një kuadër për qëllime të veçanta) për të përmbushur kërkesat e atij rregullatori. Drejtimi nuk ka një zgjedhje të kuadrit të raportimit financiar.
- Kuadri i zbatueshëm i raportimit financiar është një kuadër i pajtueshmërisë.
- Kushtet e angazhimit të auditimit reflektojnë përshkrimin e përgjegjësisë së drejtimit për pasqyrat financiare, sipas SNA 210.
- Bazuar në evidencën e auditimit të siguruar, audituesi ka arritur në përfundimin se duhet të jepet një opinion i pamodifikuar (d.m.th. “i pastër”).
- Kërkesat përkatëse etike që zbatohen për auditimin janë ato të juridiksionit.
- Bazuar në evidencën e auditimit të siguruar, audituesi ka arritur në përfundimin se ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e entitetit për të vijuar veprimtarinë sipas SNA 570 (i rishikuar). Paraqitja në pasqyrat financiare e pasigurisë materiale është e përshtashme.
- Shpërndarja dhe përdorimi i raportit të audituesit nuk janë të kufizuara.
- Audituesit i kërkohet nga rregullatori të komunikojë çështjet kryesore të auditimit në pajtim me SNA 701.
- Paragrafi për Çështjet e Tjera i referohet faktit që audituesi ka nënshkruar gjithashtu raportin e auditimit të pasqyrave financiare të përgatitur nga Shoqëria ABC për të njëjtën periudhë në përputhje me një kuadër të raportimit për qëllime të përgjithshme.
- Audituesi ka përcaktuar se nuk ka asnjë informacion tjetër (p.sh., kërkesat e SNA 720 (i rishikuar) nuk zbatohen).
- Personat që janë përgjegjës për mbikëqyrjen e pasqyrave financiare ndryshojnë nga ata që janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare.

KONSIDERATA TË VEÇANTA—AUDITIMET E PASQYRAVE FINANCIARE TË  
PËRGATITURA NË PËRPTHJE ME KUADROT PËR QËLLIME TË VEÇANTA

- Audituesi nuk ka përgjegjësi të tjera për të raportuar, të cilat të kërkojnë nga ligji dhe rregullat lokale.

## RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

[Drejtuar Aksionarëve të Shoqërisë ABC ose Adresa e duhur]

### Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë tregtare ABC (shoqëria), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 20X1, dhe pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, (*ose japin pamjen e vërtetë dhe të drejtë për*) pozicionin financiar të Shoqërisë me datën 31 Dhjetor 20X1, performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me dispozitat e raportimit financiar të Seksionit Y të Rregullatorit Z.

### Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në *[juridiksionin]*, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

### Theksimi i Çështjes - Baza Kontabël

Ne tërheqim vëmendjen tek Shënimi X në pasqyrat financiare, i cili përshkruan bazën kontabël. Pasqyrat financiare janë përgatitur për të ndihmuar Shoqërinë të zbatojë kërkesat e Rregullatorit DEF. Si rezultat, pasqyrat financiare mund të mos jenë të përshtatshme për një qëllim tjetër. Opinioni ynë nuk është i modifikuar lidhur me këtë çështje.

### Pasiguria Materiale në lidhje me Vijueshmërinë

Ne tërheqim vëmendjen tek Shënimi 6 në pasqyrat financiare, i cili tregon se kompania pati një humbje neto prej ZZZ gjatë vitit që përfundon me datë 31 Dhjetor 20X1 dhe nga ajo datë, detyrimet afatshkurtra të Shoqërisë tejkalojnë totalin e aktiveve me YYY. Siç është përshkruar në Shënimin 6, këto ngjarje ose rrethana, sëbashku me çështje të tjera të përcaktuara në Shënimin 6, tregojnë se ekziston një pasiguri materiale që mund të krijojë dyshime të mëdha lidhur me aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi. Opinioni ynë nuk është i modifikuar lidhur me këtë çështje.

### Çështjet Kryesore të Auditimit

Çështje kryesore të auditimit janë ato çështje që, në gjykimin tonë profesional, kanë qenë më të rëndësishmet në auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale. Këto çështje kanë qenë adresuar në kontekstin e auditimit të pasqyrave financiare në tërësi dhe të formimit të opinionit tonë në lidhje me to, kështu që për këto çështje ne nuk japim opinion

KONSIDERATA TË VEÇANTA—AUDITIMET E PASQYRAVE FINANCIARE TË  
PËRGATITURA NË PËRPTHJE ME KUADROT PËR QËLLIME TË VEÇANTA

të veçantë. Përveç çështjes së përshkruar me lart në seksionin e Pasigurisë Materiale në lidhje me Vijueshmërinë, ne kemi përcaktuar çështjet më poshtë si çështje kryesore të auditimit që komunikohen në raportin tonë të auditimit.

[Përshkrimi për çdo çështje kryesore të auditimit në pajtim me SNA 701, siç zbatohet në këtë auditim.]

### Çështje të Tjera

Shoqëria ka përgatitur një paketë të pasqyrave financiare për vitin që përfundon me 31 Dhjetor, 20X1 në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar për të cilat ne kemi lëshuar një raport të veçantë të audituesit për aksionerët e Shoqërisë të datës 31 Mars, 20X2.

### Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare<sup>29</sup>

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me dispozitat e raportimit financiar të Seksionit Y të Rregullores Z<sup>30</sup> dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç nëse drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveçse të veprojë në këtë mënyrë.

Personat që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

### Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk një është garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Paragrafi 41(b) i SNA 700 (i rishikuar) shpjegon se materiali i hijëzuar më poshtë mund të vendoset në një Shtojcë të raportit të audituesit. Paragrafi 41(c) i SNA 700 (i rishikuar) shpjegon se referenca mund të bëhet tek faqja e internetit e autoritetit të përshtatshëm e cila

<sup>29</sup> Ose terma të tjerë që janë të përshtatshëm në kontekstin e kuadrit ligjor në juridiksionin e caktuar.

<sup>30</sup> Kur përgjegjësia e drejtimit është të përgatitë pasqyra financiare që japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë, kjo mund të lexohet: “Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare që japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë në përputhje me dispozitat e raportimit financiar të seksionit Y të Rregullores Z, dhe për të tilla ...”

**KONSIDERATA TË VEÇANTA—AUDITIMET E PASQYRAVE FINANCIARE TË  
PËRGATITURA NË PËRPUTHJE ME KUADROT PËR QËLLIME TË VEÇANTA**

përmban përgjegjësitë e audituesit, kur ligji, rregullat ose standardet kombëtare të auditimit e lejojnë shprehimisht, në vend që ky material të përfshihet në raportin e audituesit, duke u siguruar që përshkrimi në faqen e internetit trajton, dhe nuk është në kundërshtim me, përshkrimin e përgjegjësiave të audituesit më poshtë.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticismin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale në pasqyrat financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.<sup>31</sup>
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijmësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shënimet shpjeguese, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në një mënyrë që jep paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Ne gjithashtu, ju japim personave të ngarkuar me qeverisjen një deklaratë që ne jemi në pajtim me kërkesat përkatëse etike në lidhje me pavarësinë, dhe ju komunikojmë atyre të

<sup>31</sup> Kjo fjali duhet të modifikohet, sipas rastit, në rrethanat kur audituesi gjithashtu ka përgjigjësinë për të lëshuar një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm së bashku me auditimin e pasqyrave financiare.



KONSIDERATA TË VEÇANTA—AUDITIMET E PASQYRAVE FINANCIARE TË  
PËRGATITURA NË PËRPTHJE ME KUADROT PËR QËLLIME TË VEÇANTA

gjitha lidhjet dhe çështjet e tjera që mundet në mënyrë të arsyeshme, të ndikojnë në pavarësinë tonë, dhe kur është e zbatueshme, masat mbrojtëse përkatëse.

Nga çështjet e komunikuar personave të ngarkuar me qeverisjen, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishmet për auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale dhe për pasojë edhe çështje kryesore të auditimit. Ne i përshkruajmë këto çështje në raportin tonë të auditimit përveç nëse kur ligji ose rregullat e ndalojnë bërjen publike të çështjes ose kur, në raste jashtëzakonisht të rralla, ne vendosim që çështja të mos komunikohet në raportin tonë për arsye se pasojat negative nga një komunikim i tillë pritet në mënyrë të arsyeshme të tejkalojnë përfitimet në favor të interesit publik.

Parteri i angazhimit në auditim që rezulton në këtë raport të audituesit të pavarur është [emri].

*[Nënshkrimi në emër të firmës së auditimit, emrin personal të audituesit ose të dyja bashkë, cilado është e përshtatshme në juridiksionin e caktuar]*

[Adresa e Audituesit] [Vendoset data dhe adresat]

[Data]